



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

Makroekonomia I EKB0009

Bartësi i lëndës:	Alban Zogaj
Email:	alban.zogaj@riinvest.net
Telefoni:	038 224 322
Mësimdhënësit e Lëndës:	Fisnik Bajrami

Hyrje

Makroekonomia i jep një pasqyrë të koncepteve themelore të funksionimit të ekonomisë në nivel nacional. Në veçanti trajtohet ekuilibri makroekonomik (kërkesa dhe oferta agregate), investimet, bruto produkti vendor (GDP), e agregatet tjerë, për të kaluar më pas në problematikën e inflacionit, papunësisë, rritjes ekonomike dhe mënyrën e funksionimit të sistemit bankar. Pasi të krijohet një pasqyrë për mënyrën e funksionimit të një ekonomie kalohet në analizën e ndërhyrjes së shtetit dhe instrumentet që përdoren në kuadër të politikës monetare dhe fiskale për t'i arritur objektivat makroekonomike. Sot në kohën e globalizimit problemet e tregtisë ndërkombëtare janë më të rëndësishme se kurrë, dhe kjo në mënyrë të veçantë vlen për një vend të vogël si ai i Kosovës. Për këtë arsye shkurtimisht trajtojmë ekonominë e hapur. Tema e fundit i kushtohet problemeve specifike të vendeve në zhvillim siç është Kosova.

Qëllimet

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që; 1. Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën ekonomike, problemet e drejtpeshimit dhe rritjes ekonomike duke përdorur treguesit makroekonomik të shpjeguar gjatë këtij kursi; 2. Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale dhe monetare në lëvizjet e agregateve kryesorë makroekonomikë në kontekst të situatave të caktuara në vend; 3. Të vlerësojnë efektet e lidhjeve ndërkombëtare në ekonominë e vendit; 4. Te prezantojnë në forme tabelore, grafike, dhe në modele të thjeshta matematikore mendimet e tyre mbi problemet, si dhe të formulojnë mendimet e tyre nëpërmjet eseve për tema të caktuara;

Rezultatet e pritura të lëndës

Të formojnë opinionin e tyre në lidhje me situatën ekonomike, Problemet e drejtpeshimit dhe rritjes ekonomike duke përdorur treguesit

- makroekonomik të shpjeguar qatë këtij kursi

- Të vlerësojnë efektin e politikave fiskale dhe monetare në lëvizjet e agregateve kryesorë makroekonomikë në kontekst të situatave të caktuara në vend
 - Të vlerësojnë efektet e lidhjeve ndërkombëtare në ekonominë e vendit
- Te prezantojnë në forme tabelore, grafike, dhe në modele të thjeshta matematikore mendimet e tyre mbi problemet, si dhe të formulojnë mendimet e tyre nëpërmjet eseve për tema të caktuara

Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Hyrje në makroekonomi	Ligjeratë dhe Ushtrime
2	Matja e të ardhurave të një kombi.	Ligjeratë dhe Ushtrime
3	Matja e kostos së jetesës. Llogaritja e ICK-së. Deflatori i GDP-së.	Ligjeratë dhe Ushtrime
4	Prodhimi dhe rritja. Përcaktuesit e rritjes ekonomike.	Ligjeratë dhe Ushtrime
5	Kursimi, investimi dhe sistemi financiar. Institucionet dhe tregjet financiare.	Ligjeratë dhe Ushtrime
6	Papunësia - Definicioni dhe llojet e papunësisë. Tregjet e punës.	Ligjeratë dhe Ushtrime
7	Sistemi monetar - Paraja, funksionet dhe oferta e parasë.	Ligjeratë dhe Ushtrime
8	Shtimi i parasë dhe inflacioni. Shkaqet dhe pasojat e inflacionit.	Ligjeratë dhe Ushtrime
9	KOLLOKVIUMI	Përfshinë Javët 1-8
10	Studimi makroekonomik i ekonomive të hapura: Konceptet bazë. Lëvizjet ndërkombëtare të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit.	Ligjeratë dhe Ushtrime
11	Kërkesa dhe Oferta Agregate - Luhatjet (ciklet) ekonomike	Ligjeratë dhe Ushtrime
12	Politika monetare dhe fiskale - Ndikimi i politikës monetare dhe fiskale mbi kerkesen totale.	Ligjeratë dhe Ushtrime
13	Kembimi afatshkurter midis inflacionit dhe papunesise	Ligjeratë dhe Ushtrime
14	Bilanci i Pagesave - Aplikim i teorisë makroekonomike: Shembuj nga konteksti kosovar.	Ligjeratë dhe Ushtrime
15	Prezantime dhe diskutime	Aplikim i teorisë makroekonomike: Shembuj nga konteksti kosovar

Informata shtesë 1:

Pas ligjeratave studentët punojnë në detyra konkrete, ku merren shembuj të ekonomisë kosovare, por edhe të rajonit. Në disa raste do të ketë edhe musafirë ligjerues nga institucionet publike dhe organizatat e ndryshme, të cilët merren me politikën kyçe ekonomike.

Informata shtesë 2:

1. Prezantime në power-point; 2. Video dokumentarë; 3. Detyra në grup.

Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Prezentim	20	Po	
2	Kolokvium	40	Po	
3	Kolokvium	40	Po	

Kushtet e përsëritjes:

Studentët duhet të marrin pjesë në të gjitha elementet e vlerësimit. Për të përfunduar lëndën me sukses, ata duhet të arrijnë së paku 50% të pikëve në secilin element të vlerësimit dhe së paku 50% të pikëve në përgjithësi (llogaritur si mesatare e peshuar). Sipas rregullores së Kolegjit Riinvest, studentët obligohen të kalojnë me sukses lëndën brenda 3 afateve të provimit. Nëse studentët nuk i nënshtrohen provimit në afatin e dhënë, atëherë llogaritet se kanë shpenzuar afatin dhe mundësinë. Studenti që nuk arrin ta përfundojë provimin me sukses herën e parë duhet t'i nënshtrohet përsëri vlerësimit në elementet që nuk i ka përfunduar me sukses. Nëse studentët nuk arrijnë që ta kalojnë lëndën në mundësin e parë në fund të ligjëratave, atëherë vlerësimet e mëhershme (rezultatet e kolokviumeve) gjatë ligjëratave ju ruhen deri në afatin e tretë pra afatin shtatorit. Nëse pas 3 mundësive për nënshttrim të provimit brenda një viti akademik, studentët nuk kalojnë lëndën, atëherë ata obligohen të e përsërisin sërish lëndën në vitin vijues akademik.

Burimet:

- Mankiw, N.G. dhe Taylor, M.P. 2012. Ekonomiksi: Makroekonomia.

Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin	
Ligjerata:	30	
Ushtrime:	30	
L+U:	0	
Seminar/praktike.:	10	
Studim i vazhdushem:	80	
Pregaditja e Provimit:	57	
Pjesemarrja ne teste:	4	
Pjesemarrja ne provimin final:	3	
Me profesorin dhe asistentin:	15	
Total Ore:	229	
ECTS:	9	